

KRONIKË E ZEZË

Policia sulmohet sërish në veri



Policia e Kosovës është sulmuar sërish në veri të vendit. Në orët e para të së martës, në fshatin Zupç të Zubin Potokut, një automjet i Policisë është sulmuar me armë zjarri, ka konfirmuar për KOHËN, zëdhënësi i këtij institucioni, Bakî Kelani.

Ai ka thënë se nuk ka të lënduar, por vetëm dëme materiale.

"Lidhur me rastin janë ndërmarrë të gjitha veprimet e menjëhershme policore, në vendngjarje kanë dalë edhe njësitet policore të rendit nga stacioni policor Zubin Potok, të cilat kanë njoftuar se njësiti kufitar është sulmuar me armë zjarri. Përveç dëmeve materiale në automjet nuk raportohet për zyrtarë të lënduar", ka thënë Kelani.

Sipas tij, Policia e Kosovës në bashkëpunim dhe koordinim me organet e drejtësisë janë duke i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme hetimore lidhur me rastin.

Ai ka bërë të ditur se janë shtuar masat policore me qëllim të sigurisë së zyrtarëve policorë dhe qytetarëve.

Në fakt, ky nuk është sulmi i parë ndaj Policisë në veri të vendit. Më 15 prill u sulmuan dy vetura të Policisë së Kosovës që po bartnin zyrtarët policorë për në pikat kufitare në veri. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka njoftuar se sulmi kishte ndodhur me granatë dore dhe armë AK-47. Një sulm kishte ndodhur edhe një më ditë më pas, në Sharpej të Jarinjës.



© KOHA. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Komento

#POLICIA

#SULM

#VERI

TË TJERA



Në Skenderaj vidhet një Golf 3



Arrestohet një serb në Vermicë, tentoi t'i korruptonte policët me 5 euro



Ikën një person nga Klinika e Psikiatrisë në Prishtinë



Arrestohet hajni i katër veturave në Prizren